



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr.167..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 27/ 12 / 2023

VENDIM

Nr. 44, date 27 /12/2023

PËR

**PROBLEMATIKAT NË LIDHJE ME SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN, MONITORIMIT
DHE SIGURISË SË DIGËS SË LIQENIT TË ZI “TEODORI 2003”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 27.12.2023 mori në shqyrtim problematikat e konstatuara gjatë vitit 2023 në lidhje me shfrytëzimit, monitorimin dhe sigurinë e digës së Liqenit të Zi e cila është pjesë përbërëse e kompleksit të digave të HEC Tërnovës që administrohet dhe shfrytëzohet nga Kompania "TEODORI 2003".

Nga Informacionet e ardhura në KKDM si dhe konstatimet e vërejtura gjatë kësaj periudhe, rezulton se:

- Shfrytëzuesi i kompleksit të digave të Liqenit të Zi, liqenit të Sopeve, Liqenit të fushës së Zogut dhe Liqenit të bardhë, nuk ka paraqitur asnjë rregullore të shfrytëzimit, monitorimit dhe sigurisë së këtyre digave të kërkuar në nenin 29 të VKM Nr. 147 të mësipërme.
- Shfrytëzuesi i këtyre digave prej me se 10 vitesh nuk ka kryer asnjë matje batimetrike për rezervuarët e krijuar nga digat e mësipërme të kërkuara në nenin 30 të VKM Nr. 147 të dhënë më sipër
- Shfrytëzuesi i diges nuk ka përgatitur asnjë plan të gadishmerise ne rastet e emergjencave civile per shka te prishjes se diges apo prurjeve te medha qe mund te vijne ne kete zone
- Shfrytëzuesi i diges nuk ka instaluar ndonjë sistem monitorimit të diges sipas kërkesave të nenit 32, pika 2 e VKM Nr. 147 të mësipërme

Aktualisht, në këto kompleks janë evidentuar probleme teknike të shumta në sistemin e shkarkimit të ujrave të tepërta dhe sistemin e marrjes së ujit, etj.

Keshilli Teknik i Perhershëm i Digave (KTPD) i rekomandoi antarëve të KKDM ti kërkoj pronarit dhe administratorit të diges (Teodori 2003) të përgatit një rregullore për shfrytëzimin, operimin, mirëmbajtjen, monitorimin dhe sigurinë e diges së madhe të Liqenit të Zi dhe kompleksit të digave që shfrytëzohen prej tij e cila duhet të marrë në konsideratë problematikat e përmenduar më sipër dhe plotësimin e kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe udhëzimit përkatës të KKDM të përmendur më sipër.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Ti kërkoj shfrytëzuesit të diges së Liqenit të Zi dhe kompleksit të digave që shfrytëzohen prej saj :
 - Përgatitjen dhe dorëzimin pranë KKDM të **rregullores së shfrytëzimit, mirëmbajtjes, operimit dhe sigurisë për digën e Liqenit të Zi dhe kompleksit të digave që ndodhen në zonë dhe që shfrytëzohen prej kompanisë "TEODORI 2003"** në përputhje me kërkesat e nenit 29 të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 dhe vendimit të KKDM Nr. 03, datë 19.10.2020; Rregullorja duhet të marrë në konsideratë të gjitha problematikat dhe situatën aktuale të përshkruar në këtë Vendim, të përfshijë të dhenat teknike për digën, qëllimin aktual të përdorimit të diges dhe rezervuarit, rregulloren e monitorimit të diges sipas kërkesave të nenit 31 dhe 32 të VKM se mësipërme. rregulloren e shfrytëzimit gjatë periudhës uje shume dhe ujepakte në funksion të qëllimit të përdorimit të saj, të dhenat për grupin e sigurisë së diges si dhe Planin e gadishmerise ne rastet e emergjencave civile.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Përgatitjen dhe dorezimin pranë KKDM të Planit të Emergjencave civile për rastet e prishjes së digës dhe prurjeve të mëdha;
- Kryerjen e matjeve batimetrike në rezervuarin e krijuar dhe analizen e sedimenteve sipas kërkesave të nenit 30 të VKM Nr. 147 të dhënë me siper;
- Marrjen e masave për Instalimin e sistemeve të monitorimit në dige dhe Sistemit të alarmit në dige dhe në zonën urbane poshtë saj sipas kërkesave të shprehura në nenin 32 dhe 35 të VKM Nr. 147 të dhënë me siper;

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në këtë vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

